



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1776, datë 20.02.2012

Për

“Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, ndryshuar me VKD nr. 1530, datë 18.3.2011”

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | | | |
|----|------|--------|------------|---------|
| 1. | Z. | Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. | Z. | Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. | Znj. | Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. | Z. | Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. | Znj. | Zamira | Nurçe | Anëtar |

Dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.02.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërorë edhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim, çështjen me objekt:

“Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” ndryshuar me VKD nr. 1530, datë 18.3.2011”

BAZA LIGJORE:

1. Kodi i Procedurës Administrative (**KPrA**);
2. Shkronja p) e nenit 8, nenet 87, 88 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
3. Rregullore Nr. 13, datë 16.04.2010 për “ Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010 (**Rregullore**), ndryshuar me VKD nr. 1530, datë 18.3.2011;
4. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendshme të AKEP (ish ERT)” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (**VKD**) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin
- Dokumenti për “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”, ndryshuar me VKD nr. 1530, datë 18.3.2011;
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe,

- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E H E T se :

1. Dokumentacioni për “Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”, ndryshuar me VKD nr. 1530, datë 18.3.2011, i përgatitur nga Grupi i punës sipas Urdhër Nr. 769, datë 17. 11. 2011 “Për ngritje grup-pune” me qëllim: *Rishikimin e Rregullores Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1219, datë 07. 04. 2010*, dhe i konsultuar publikisht me palët e interesit sipas nenit 110 të ligj nr. 9918, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në:

1. Kodin e Procedurave Administrative;
2. Shkronjën p) të nenit 8 dhe nenet 87, 88 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
3. Pikën 17 të nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” , miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (*VKD*) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

VENDOS

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime sipas dokumentit bashkëlidhur në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit” miratuar me VKD Nr. 1219, datë 07. 04. 2010”, ndryshuar me VKD Nr. 1530, datë 18.3.2011.
2. i. Afati i realizimit të përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve nga sipërmarrësit në bazat e të dhënave të tyre, të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të këtij akti nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.

- ii. Afati i realizimit të procesit të automatizimit të plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve, nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të këtij akti nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.

3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____

“Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010””

1. Në pikën 5 të nenit 4 të Rregullores **të hiqet** fjalia “*Kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 6(gjashhtë) muaj*”.

2. Në nenin 4 të Rregullores, pas pikës 6 **të shtohet** pika 7 me këtë përmbajtje:

*“7. Pajtimtarët janë të detyruar që të njoftojnë sipërmarrësin me të cilin kanë lidhur kontratën e pajtimit, për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të rregjistruara në bazën e të dhënave të sipërmarrësit **te bazuar ne dokumentacionin perkates**”.*

3. Në pikën 6 të nenit 5 të Rregullores **të hiqet** togfjalëshi brenda kllapave në rreshtin e katërt “*(neni 4 pika 5 e kësaj rregulloreje)*”.

4. Pika 1 e nenit 7 të Rregullores **të ndryshojë** dhe bëhet:

*“1. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, **nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit** duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numra të bartur gjeografikë dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.*

5. Pika 3 e nenit 14 të Rregullores **të ndryshojë** dhe bëhet:

*“3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit marrës. **Operatori marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda afatit te percaktuar ne kete rregullore korrigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje**”.*

6. Në pikën 2 të nenit 15, pas paragrafit të fundit **të shtohet** paragrafi me këtë përmbajtje: *“Në raste të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe operatorin marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar ne te dhenat e Pajtimtarit me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore”.*

7. Pika 2 e nenit 17 të rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit dhënës. Duke respektuar parimin “one-stop-shop” të bartjes së numrit , operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orëve pune duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes”.

8. Shkronja b) e pikës 2 të nenit 19 të ndryshojë dhe bëhet:

“b) Operatorët me nën 100.000 pajtimtarë janë të detyruar të fillojnë të përdorin bazën e të dhënave referencë të centralizuar për importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve, jo më vonë se një muaj pas themelimit dhe testimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar.

Këta operatorë, sipas afateve të përcaktuara nga AKEP-i, gjithashtu janë të detyruar të aplikojnë automatizimin e plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve”.

9. Tek Shtojca e Rregullores “Kërkesa për bartjen e numrit”, pika 1 e deklarimit të pajtimtarit të ndryshojë dhe bëhet:

*“ 1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës, **kam njoftuar ndryshimin e të dhënave të mia të regjistruara tek baza e të dhënave të këtij operatori (nëse ka patur ndryshime të tilla), dhe dëshiroj të anuloj kontratën me operatorin dhënës për këto numra”.***

10. Një korrektim në Nenin 15 të rregullores. Ndryshon numri në renditjen e paragrafëve, ishte paragrafi me numrin 3 dhe në vijim numri 5 , bëhet paragrafi me numrin 3 dhe në vijim numri 4.

Përfundimet e Këshillimit Publik

Për:

“Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”” dhe “Përcaktime në aktin administrativ vendimmarrës”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në zbatim të Vendimit Nr. 1729, datë 20.12.2011, të Këshillit Drejtues, ka nisur procedurën e këshillimit publik për **“Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me VKD nr. 1219, datë 07. 04. 2010”” dhe “Përcaktime në aktin administrativ vendimmarrës”**.

Në përfundim të afatit prej 30 ditësh të përcaktuar në vendimin e mësipërm të KD, rezulton se në adresë të AKEP kanë ardhur komente dhe mendime në lidhje me **“Disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren Nr. 13, datë 16. 04. 2010, “Për Portabilitetin e Numrit”** nga palët e interesuara.

Të interesuarit ju kanë dhënë përgjigje pyetjeve të adresuara në dokumentin e këshillimit publik si dhe kanë bërë komente e kanë dhënë opinione në lidhje me këtë dokument.

Këto komente paraqiten në vijim të këtij dokumenti, respektivisht :

AKEP ka propozuar ndryshimin:

1. Në pikën 5 të nenit 4 të Rregullores **të hiqet** fjalia “Kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 6(gjashtë) muaj”.

Komentet e operatorëve:

OPERATORI B:

Ky ndryshim reflekton në fakt kërkesat e bëra nga operatorët për të operuar me kontratat e abonentit si në një proces normal abonimi, duke eliminuar situatën për ta mbajtur klientin 6 muaj ku ai s'kishte të drejtë të ndërpresë një marrëdhënie kontraktore me pasojat e saj për 6 muaj. Ky ndryshim është i pranueshëm nga ana jonë

OPERATORI C:

OPERATORI C shprehet dakord me sugjerimin që në Nenin 4 pika 5 të Rregullores **të hiqet** fjalia “kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj”.

OPERATORI C propozon që pika pika 6 të ndryshohet si mëposhtë:

“Kontrata mes Pajtimtarit dhe Operatorit Marrës mund të parashikojë që Pajtimtari të paguajë një Tarifë për Bartjen e numrit. Kjo tarifë do të mbulojë kostot administrative të Operatorit Dhënës gjatë procesit të bartjes. Tarifa e Bartjes nuk duhet të jetë më e lartë se 600 Lekë (me TVSH).”

- Praktika ka treguar se Operatorët Dhënës kanë kërkuar që një Pajtimtar që ka nënshkruar rregullisht një Kërkesë për Bartje ta tërheqë atë me mënyra nga më të ndryshmet. OPERATORI C konsideron se është i domosdoshëm saktësimi dhe formalizimi në tekstin e Rregullores së Portabilitetit për të shmangur çfarëdo interpretimi që do të krijonte hapësira për abuzim.

OPERATORI C propozon që të shtohet pika 9 si vijon:

Paraqitja e Kërkesës për Bartje nga Operatori Marrës tek Baza e të Dhënave Referencë e Centralizuar shuan përfundimisht të drejtën për të tërhequr aplikimin nga Pajtimtari dhe të drejtën për të refuzuar Pajtimtarin nga Operatori Marrës.”

Në vijim të komenteve në nenin 4 pika 5, OPERATORI C shprehet dakord me propozimin e AKEP për heqjen e frazës në pikën 6 të këtij neni [...] neni 4 pika 5 e kësaj Rregulloreje[...]

Komenti i AKEP: Operatorët pranojnë propozimin e AKEP për ndryshimin në pikën 5 të nenit 4 të Rregullores.

Propozimet e OPERATORI C për disa ndryshime të tjera në këtë pjesë të rregullores nuk kanë qënë objekt i këtij këshillimi publik.

AKEP ka propozuar ndryshimin:

2. Në nenin 4 të Rregullores, pas pikës 6 **të shtohet** pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Pajtimtarët janë të detyruar që të njoftojnë sipërmarrësin me të cilin kanë lidhur kontratën e pajtimtimit, për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të rregjistruara në bazën e të dhënave të sipërmarrësit”.

Komentet e operatorëve:

OPERATORI A:

Koment: Kjo pikë nuk është shumë e qartë. Kur duhet bërë njoftimi nga ana e pajtimtarit përpara apo pas kërkesës për bartje? Nëse supozohet që pajtimtari me iniciativën e tij , në cdo moment që ka një ndryshim në të dhënat e tij , të paraqitet tek sipërmarrësi me të cilin ka kontratë pajtimi për të reflektuar ndryshimet, si do marrë dijeni pajtimtari për këtë detyrim të tij dhe sa do të zbatohet? Ky detyrim është shumë i përgjithshëm dhe pajtimtari në fakt mund të

marrë dijëni për këtë detyrim vetëm në momentin kur do të plotësojë kërkesën për batje (duke qënë se është propozuar për të shtuar këtë detyrim edhe tek Shtojca e Rregullores "Kërkesa për bartjen e numrit", në pikën 1 të deklaramit). Megjithatë prapë kjo mbetet në vullnetin dhe ndërgjegjësimin e pajtimtarit

OPERATORI B:

Shtimi i këtij neni është i rëndësishëm sepse është pajtimtari ai që jep të dhënat e tij personale bazë të dokumentave të tij.

Megjithatë këtu duhet shtuar fraza në fund të paragrafit " **... të bazuar në dokumentacionin përkatës**" sepse nuk mund të vijë qytetari dhe të ndryshojë emrin si të dëshirojë nëse nuk e bazon në dokumentat e identifikimit, apo le të themi të dhënat e biznesit të tij pa dokumentacionin përkatës.

Për më tepër duhet marrë parasysh vendosja e një skeduli se deri në c'afat duhet të rregullohen këto të dhëna. Mendojmë të shtohet " **... të bazuar në dokumentacionin përkatës brenda 24 orësh nga marrja e dokumentacionit në ditët e zakonshme të javës dhe brenda tre diteve në se pajtimari paraqitet të Premten**"

Komenti i AKEP: Nuk ka kundërshtime lidhur me këtë propozim për ndryshim, por ka sugjerim për përmirësim të përmbajtjes. Duke marrë në konsideratë sugjerimin përmbajtja bëhet si vijon:

"7. Pajtimtarët janë të detyruar që të njoftojnë sipërmarrësin me të cilin kanë lidhur kontratën e pajtimit, për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të rregjistruara në bazën e të dhënave të sipërmarrësit të bazuar në dokumentacionin përkatës".

AKEP ka propozuar ndryshimin:

3. Në pikën 6 të nenit 5 të Rregullores **të hiqet** togfjalëshi brenda kllapave në rreshtin e katërt " (neni 4 pika 5 e kësaj rregulloreje).

Komentet e operatorëve:

OPERATORI B:

Nuk jepet arsyeja e heqjes së togfjalëshit në rreshtin e katërt.

Ne mendojmë se ky togfjalësh duhet të qëndrojë sepse qartëson më mirë nenin përkatës dhe për më tepër është në përputhje me nenin 15 dhe 17 të kontratës së abonentit të OPERATORI B të miratuar nga AKEP.

Komenti i AKEP: Vetëm OPERATORI B ka kërkuar të qëndrojë i pandryshueshëm ky nen por në fakt kjo rrjedh prej ndryshimit në pikën 5 të nenit 4 të Rregullores të propozuar në fillim të dokumentit dhe jo si një ndryshim në përmbajtje të nenit 5 pika 6.

AKEP ka propozuar ndryshimin:

4. Pika 1 e nenit 7 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

*“1. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, **nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit** duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numra të bartur gjeografikë dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.*

Komentet e operatoreve:

OPERATORI B:

Jemi plotësisht dakort me ndryshimin e këtij neni i cili merr parasysh se të gjithë operatorët e shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun duhet të kryejnë automatizimin e plotë të procesit. Mendojmë se ky përcaktim duhet të ishte bërë që në fillim kur u hartua rregullorja për NP, sepse do të kishte bërë që cilësia e shërbimit të pajtimtarit do të ishte më e mirë dhe nuk do të krijonte mjaft probleme që u evidentuan gjatë procesit të NP që nga muaji Maj i vitit 2011 kur ky proces filloi

OPERATORI C:

Në kuadër të komenteve tona për automatizimin e plotë për të gjithë operatorët, OPERATORI C sugjeron formulimin si më poshtë për pikën 1 të nenit 7 të Rregullores :

*“Të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, duhet të sigurojnë rrugëzimin korrekt të thirrjeve në numrat e bartur gjeografike dhe të lëvizshëm **nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit, përfshirë përditësimin e të dhënave në platformat respektive.** Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.*

- OPERATORI C shprehet se pamundësia e marrjes së masave ndaj operatorëve që nuk kryejnë portabilitetin sipas rregullores ka qenë një problem i përsëritur që ka krijuar ndër shqetësimet kryesore në tregun shqiptar pas hedhjes në treg të shërbimit të portabilitetit të numrit. Sidomos, e drejta për të pezulluar terminimin e thirrjeve të përcjella nga operatorët shkelës (përfshirë rastin kur këta nuk janë të lidhur drejtpërdrejtë me operatorin që shërben Pajtimtarin në fjalë) është tepër e rëndësishme. Këta kanë në parim detyrimin për të rrugëzuar thirrjet aty ku duhet dhe nëse nuk e kryejnë një veprim të tillë duhet që të parashikohet masa përkatëse penalizuese.

OPERATORI C propozon që në Nenin 7 të shtohet pika 2 si më poshtë vijon:

“Në rast të moszbatimit nga cdo operator i detyrimit për rrugëzim sipas metodës ACQ, sipas pikës 1 mësipër, operatori që shërben pajtimtarin që nuk ka marrë thirrjen e dështuar ka drejtë që të pezullojë menjëherë terminimin e thirrjeve të përcjella nga operatori në shkelje e më pas të zgjidhë marrëveshjen e interkoneksionit përkundrejt njoftimit paraprak. Procedura e zgjidhjes ose pezullimit bëhet sipas përcaktimeve të ORI-t dhe Marrëveshjeve përkatëse të Interkoneksionit. Në rast se detyrimi për kryerjen e rrugëzimit sipas metodës ACQ kryhet nga një Operator Tranzitues sipas përcaktimeve të pikës 4 mëposhtë, të drejtat e zgjidhjes dhe pezullimit lindin në raport me Operatorin Tranzitues.

Komenti i AKEP: Operatorët janë dakort me ndryshimin e propozuar por sugjerojnë përmirësime të mëtejshme. AKEP mendon se sugjerimet nuk janë objekt i këtij këshillimi publik por do të merren në konsideratë në proceset e mëtejshme rregullatore.

AKEP ka propozuar ndryshimin:

5. Pika 3 e nenit 14 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

*“3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit marrës. **Operatori marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda një afati sa më të shkurtër korigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje**”.*

Komentet e operatoreve:

OPERATORI A:

Koment: Kjo pjesë e procesit është midis operatorit marrës, databazën qëndrore (CRDB) dhe pajtimtarit. Pra operatori dhënës nuk përfshihet akoma në këtë fazë.

Nga ana tjetër duhen sqaruar: Cila është procedura që do të ndiqet për të korigjuar gabimin? Sa është afati "sa më i shkurtër"?

OPERATORI B:

Në lidhje me amendimin e pikës 3 të Rregullores në fuqi për portabilitetin e numrit, AKEP ka shtuar paragrafin e mëposhtëm në vazhdim të pikës 3 të Rregullores:

"Operatori marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda një afati sa më të shkurtër korigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje".

Ne mendojmë që ky ndryshim bie në kundërshtim me pikën 7 të nenit 4 të Rregullores (të propozuar për shtim në nenin 4), i cili detyron pajtimtarët të lajmërojnë sipërmarrësit me të cilët kanë lidhur kontratën e pajtimit, për cdo ndryshim të të dhënave të tyre, në bazën e të dhënave të sipërmarrësit. Në këtë rast sipërmarrësit, sipas rregullores, do të kenë të përditësuara të dhënat e

pajtimtarëve të tyre, pasi pajtimtari në cdo moment është i detyruar të njoftojë sipërmarrësit për cdo ndryshim në të dhënat e tij.

Paragrafi i ri që shtohet, gjithashtu nuk përcakton qartë dhe afatin brenda të cilit duhet të korrigohej ky gabim, pasi momenti që operatori dhënës ka dërguar kërkesën për bartje DBRC-së dhe kohës që arrin deri tek operatori marrës është shumë i shkurtër (deri në 5 minuta sipas rregullores).

Sipas propozimit tonë **Pika 7 Neni 4 i Rregullores** si më sipër ky afat pak a shumë përcaktohet. Prandaj, mendojmë që ky paragraf të rishikohet dhe njëherë, në mënyrë që të jetë në përputhje me pikën e sipërpërmendur. Nuk mund të lihen togfjalësha "**në një afat sa më të shkurtër**" të cilat krijojnë precedentë për mosveprim në kohën e duhur.

OPERATORI C:

OPERATORI C konsideron se ky ndryshim i propozuar nga AKEP për pikën 3 të nenit 14 është i pabazë dhe nuk duhet përfshirë pasi, neni 14 përcakton procesin e punës të Bazës Qendrore të të Dhënave që ka për funksion të vlerësojë nëse mesazhi i dërguar është teknikisht e saktë dhe nuk duhet të ngatërrohet me procesin e korrigjimit të databazave të Operatorit Dhënës.

OPERATORI C konsideron se është e nevojshme një saktësim i Rregullores së Portabilitetit për të qartësuar arsyet e refuzimit të një Kërkesë për Bartje nga Operatori Dhënës. Këto saktësime janë të domosdoshme sepse praktika ka treguar që mungesa e konsistencës në elemente të tillë të informacionit ka krijuar hapësira për refuzim të Kërkesave për Bartje si dhe abuzim (qoftë edhe nga Pajtimtarë mashtrues). Identifikimi i Pajtimtarëve mund të bëhet vetëm nëpërmjet datëlindjes dhe jo numrit të identitetit (ID)..

OPERATORI C propozon:

Në Nenin 14, pika 2.c ndryshohet si mëposhtë:

“datën e lindjes së pajtimtarit, nëse pajtimtari është individ”.

Komenti i AKEP: Duke marrë në konsideratë sugjerimet e operatorëve për propozimi për ndryshim bëhet si më poshtë:

5. Pika 3 e nenit 14 të Rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

*“3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit marrës. **Operatori marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda afatit të përcaktuar në këto rregullore korrigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje”.***

Një pjesë e komenteve të tjera lidhur me këtë çështje nuk kanë qënë objekt i këtij këshillimi publik

AKEP ka propozuar ndryshimin:

6. Në pikën 2 të nenit 15, pas paragrafit të fundit të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“ Në raste të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe operatorin marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore”.

Komentet e operatoreve:

OPERATORI B:

Formulimi i paragrafit që i shtohet pikës së mësipërme të nenit 15 bie në kundërshtim me pikën 3 të nenit 14 të Rregullores, pasi në njërin rast detyrohet operatori marrës, dhe në rastin në fjalë operatori dhënës (në rast të një përgjigje negative). Ne mendojmë që dhe në rastin e parë duhet të jetë operatori dhënës të bashkëpunojë me operatorin marrës në rast të një gabimi të konstatuar gjatë fazës së bartjes, pasi kërkesa vjen nga operatori marrës, dhe në përgjigje të saj operatori dhënës duhet të jetë i detyruar të bashkëpunojë.

OPERATORI C:

OPERATORI C është i mendimit që të saktësohet që bëhet fjalë për të *“mundësuar korrigjimin e të dhënave të pasakta të Pajtimtarit”* pasi Operatori Dhënës mund të refuzojë vetëm për mospërputhje të të dhënave të pajtimtarit dhe për asnjë arsye tjetër.

OPERATORI C propozon si vijon pikën 2 të nenit 15:

“në rast të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarë dhe operatorin marrës për të mundësuar korrigjimin e të dhënave të pasakta të Pajtimtarit të konstatuar me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore”.

- OPERATORI C kërkon që të shfuqizohet pika 2.c.aa /neni 15 pasi nuk ka të bëjë fare me procesin e vlerësimit të Kërkesës për Bartje nga ana e Operatorit Dhënës. Një Operator Dhënës mund të refuzojë vetëm për mospërputhje të të dhënave personale të identifikimit të pajtimtarit (numër telefoni, emër dhe mbiemër, datëlindje, numër NIPT) sic e dhe përcaktohet në Rregulloren e Portabilitetit.
- OPERATORI C për të njëjtat arsye si edhe në nenin 14 më lart, propozon që Neni 15, pika 1.b ndryshohet si mëposhtë:

“nëse emri, data e lindjes ose numri NIPT i rregjistrimit të Pajtimtarit i paraqitur në Kërkesën për Bartje përputhet me detajet e pajtimtarit në bazën e të dhënave të Operatorit Dhënës”.

Në Nenin 15, pika 2.c.ëe ndryshohet si mëposhtë:

“data e lindjes së Pajtimtarit të paraqitur në Kërkesën për Bartje nuk përputhet me datën e lindjes së Pajtimtarit në bazën e të dhënave të Operatorit Dhënës”.

- OPERATORI C konsideron se një saktësim i Rregullores së Portabilitetit është i nevojshme nisur nga përvoja e mbledhur deri më sot nga zbatimi i saj dhe i procesit të bartjes. Ka pasur raste kur operatorë të ndryshëm kanë refuzuar të miratojnë Kërkesa për Bartje me pretendimin se pajtimtarët në fjalë nuk kanë kontrata aktive. Një saktësim i tillë i Rregullores së Portabilitetit nuk lë shteg për asnjë interpretim të zgjeruar dhe nuk lejon hapësira për abuzim, sikurse janë vërejtur deri më sot.

Përsa më lart OPERATORI C propozon në Nenin 15, pika 1.a ndryshohet si mëposhtë:

“nëse numri që do të bartet është subjekt i një kontrate aktive në rrjetin e Operatorit Dhënës. Subjekt i një kontrate aktive është cdo Pajtimtar të cilit nuk i është zgjidhur kontrata sipas përcaktimeve të Kushteve të Përgjithshme të Ofrimit të Shërbimit të miratuara nga AKEP.”

- OPERATORI C konsideron se **standardet për automatizimin e plotë të procesit të bartjes** duhet të jenë të zbatueshme për të gjithë operatorët pa dallim dhe menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Amendamenti të Rregullores. OPERATORI C insiston që të gjithë operatorët të zbatojnë automatizimin e plotë të procesit të bartjes, që nënkupton integrimin automatik të mesazheve që shkëmbehen me Bazën Qëndrore të të Dhënave dhe zbatimin e afatit kohor prej 5 minutash për përgjigjen ndaj Kërkesës për Bartje (pra kërkimin e automatizuar të databazës së pajtimtarëve për Operatorët).

OPERATORI C propozon që në Nenin 15 të shfuqizohet pika 4 (gabimisht referuar si 5)

OPERATORI C propozon që Neni 15, pika 3 të ndryshohet si mëposhtë:

“Të gjithë Operatorët do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar Kërkesat për Bartje. Koha mes marrjes së Kërkesës për Bartje dhe Përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta në 90% të të gjitha rasteve të muajit kalendarik. Për pjesën e mbetur prej 10% të rasteve, koha e Përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 24 orë për 98% të këtyre rasteve në fjalë gjatë muajit kalendarik.”

Neni 15, pika 4 (gabimisht referuar si 6) të ndryshohet si mëposhtë:

“Orari i punës është nga 08:00 deri më 16:00 nga e hëna deri të premten, me përjashtim të festave publike”. Nëse orari i punës në një ditë përfundon para skadimit të kufirit prej 8 orëshve të punës, pjesa tjetër e afatit kohor fillon në orën 8 të ditës pasardhëse, sipas përcaktimeve të Specifikimeve Teknike miratuar nga AKEP.

Neni 15, pika 5 (gabimisht referuar si 7) të ndryshohet si mëposhtë:

“Nëse Operatorit Dhënës nuk e dërgon Përgjigjen për Bartje brenda 24 orëve sipas pikës 3 mësipër, baza e të dhënave referencë e centralizuar do të veprojë sikur të ketë pranuar përgjigje pozitive për bartje”.

Komenti i AKEP: Duke marrë në konsideratë një pjesë të sugjerimeve të operatorëve propozimi I AKEP do të formulohet si më poshtë vijon:

6. Në pikën 2 të nenit 15, pas paragrafit të fundit **të shtohet** paragrafi me këtë përmbajtje: *“Në raste të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe operatorin marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar në të dhënat e Pajtimtarit me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore”.*

Një pjesë e sugjerimeve të bëra nga operatorët nuk kanë qenë objekt i këtij këshillimi publik.

AKEP ka propozuar ndryshimin:

7. Pika 2 e nenit 17 të rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

*“2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit dhënës të diskutojë një zgjidhje të mundshme. **Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit , operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orëve pune duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes”.***

Komentet e operatoreve:

OPERATORI B:

Pika 2 Neni 17 i Rregullores thuhet që operatorët bashkëpunojnë me njëri tjetrin për të zgjidhur problemin brenda 8 orëve. Kjo bien ndesh me Nenin 4 pika 7 (e shtuar) ku pajtimtari detyrohet të paraqitet tek operatori dhënës për korrigjimin e të dhënave. Ndërkohë citohet gjithashtu sipas parimit **" Duke respektuar parimin "one stop shop" të mbartjes së numrit , operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orësh duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të mbartjes"**

Nuk është e qartë se kush do të ketë prioritetin Pika 7 Neni 4 i rregullores apo Pika 2 Neni 17., dhe si do jetë si procedure.

Përcaktohet qartë se pajtimari do të jetë përgjegjës për ndryshimin e të dhënave të tij sipas Pika 7 Neni 4 i rregullores të propozuar këtu. Ai do ta bëjë këtë me operatorin që ka lidhur kontratë.

Ndërkohë operatori që ka lidhur kontratë është operatori dhënës. Dhe në Pika 2 Neni 17 referohet paragrafi i mësipërm së operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje duke respektuar parimin "one stop shop" pra i bie që pajtimari duhet të komunikojë me operatorin marrës për të ndryshuar të dhënat por që në fakt nuk ka te lidhur një kontratë. Kontrata që po lidh është e re dhe s'ka të bëjë me të parën që ka lidhur me operatorin marrës.

Për më tepër përsëri nuk mund të lihet në një rregullore termi evaziv që "operatorët të gjejnë një zgjidhje". Duke qënë në konkurrencë operatorët nuk mund të gjejnë një zgjidhje. Është AKEP që përcakton rregullat në këtë proces.

Më tej " Brenda 8 orëve" çdomethënë brenda 8 orëve? Duhet përcaktuar "8 orëve punë" sepse procesi mbyllet në fund ditën e punës dhe nuk mund të operohet më tej apo në fund javë.

OPERATORI C:

Në lidhje me korigjimin e të dhënave të Pajtimtarëve për të mos bllokuar procesin e bartjes, OPERATORI C konsideron se një zgjidhje e tillë e propozuar nga AKEP është e paplotë. AKEP duhet të përcaktojë qartë në Rregullore ose në një dokument të vecantë Udhëzim ose Aneks në këtë Rregullore, se cila është zgjidhja në fjalë që duhet ndjekur brenda afatit 8 orë punë përkatësisht nga Operatori Dhënës dhe Operatori Marrës.

OPERATORI C konsideron se AKEP duhet të përcaktojë me hollësi procesin e shkëmbimit të informacionit mes palëve. Më konkretisht:

Hapi i 1 – Dërgimi i Kërkesës për Bartje (NPRequest)

- Operatori Marrës dërgon gjithmonë së bashku me Kërkesën për Bartje bashkëngjitur edhe kopjen e skanuar të kërkesës të nënshkruar nga Pajtimtari. Kërkesa për bartje e nënshkruar përmban edhe deklarin e Pajtimtarit që ka përditësuar të dhënat e tija tek Operatori Dhënës (sipas formatit të miratuar nga AKEP në Shtojcën 1 të Rregullores).
- Operatori Marrës dërgon gjithmonë së bashku me Kërkesën për Bartje, edhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit të Pajtimtarit (kur Pajtimtari është person fizik).
- Operatori Marrës dërgon gjithmonë së bashku me Kërkesën për Bartje, edhe kopje të skanuar të dokumentit të regjistrimit në QKR (kur Pajtimtari është person juridik) si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të Pajtimtarit. Në rast përfaqësimi nga individë të tjerë, dokumentacionit të mësipërm i bashkëngjitet një autorizim i rregullt përfaqësimi.

- Operatori Marrës dërgon gjithmonë së bashku me Kërkesën për Bartje, edhe kopje të skanuar të shkresës së protokolluar të titullarit të institucionit publik, me vulën dhe logon e institucionit publik, që kërkon bartjen e numrit/numrave.

Hapi i 2 – Dërgimi Përgjigjes së Bartjes (NPResponse)

- Nëse Operatori Dhënës konstaton se Pajtimtari, në kundërshtim me deklarin e tij tek Kërkesa për bartje e nënshkruar në pikën e shitjes së Operatorit Marrës, nuk ka përditësuar të dhënat e tija (emër, mbiemër, datëlindje ose NIPT), dërgon një Përgjigje refuzuese të Kërkesës për Bartje.
- Operatori Dhënës së bashku me Përgjigjen refuzuese të Kërkesës për Bartje dërgon gjithmonë edhe kopje të skanuar të dokumentave të Pajtimtarit që përmbajnë të dhënat që janë në mospërputhje me të dhënat e Pajtimtarit në Kërkesën për Bartje

Hapi i 3 – Kërkesë për përditësimin e të dhënave

- Operatori Dhënës kontakton menjëherë Operatorin Marrës nëpërmjet personit të kontaktit të përcaktuar në Nenin 17.1 të Rregullores dhe kërkon që Pajtimtari të bëjë kërkesë formale për përditësimin e të dhënave (emër, mbiemër, datëlindje ose NIPT). Mënyra e komunikimit përcaktohet formalisht nga AKEP.

Hapi i 4 – Përditësimi i të dhënave nga Pajtimtari

- Pajtimtari, pasi informohet nga Operatori Marrës, paraqitet në pikën e shitjes së Operatorit Dhënës dhe bën kërkesë formale për përditësimin e të dhënave të tij.
- Operatori Marrësi ri-fillon përsëri procesin e bartjes duke paraqitur Kërkesën për Bartje nëpërmjet ndërfaqes elektronike të Bazës Qëndrore të të Dhënave.

Komenti i AKEP: Duke marrë në konsideratë një pjesë të sugjerimeve të operatorëve propozimi për ndryshimin e Rregullores është si më poshtë vijon:

7. Pika 2 e nenit 17 të rregullores të ndryshojë dhe bëhet:

“2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit , operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orëve pune duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimin të procesit të bartjes”.

Sugjerimet për ndryshime të tjera nuk kane qenë objekt I këtij këshillimi public dhe do të konsiderohen në proceset e ardhshme rregullatore.

AKEP ka propozuar ndryshimin:

8. Shkronja b) e pikës 2 të nenit 19 të ndryshojë dhe bëhet:

“b) Operatorët me nën 100.000 pajtimtarë janë të detyruar të fillojnë të përdorin bazën e të dhënave referencë të centralizuar për importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve, jo më vonë se një muaj pas themelimit dhe testimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar.

Këta operatorë, sipas afateve të përcaktuara nga AKEP-i, gjithashtu janë të detyruar të aplikojnë automatizimin e plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve”.

Komentet e operatoreve:

OPERATORI B:

Shkronja b) e pikës 2 të nenit 19. Jemi plotësisht dakort për ndryshimin e këtij neni. Theksojmë se duhet të ishte bërë që në fillim.

OPERATORI C:

OPERATORI C konsideron se të gjithë operatorët e autorizuar duhet të zbatojnë automatizimin e plotë të procesit të bartjes ashtu si edhe operatorët celulare e kanë zbatuar tanime.

OPERATORI C konsideron se shkalla e automatizimit duhet të jetë e plotë dhe e njëjtë për të gjithë operatorët në treg, përfshirë përditësimin e databazave lokale për të siguruar rrugëzimin korrekt të thirrjeve sipas metodës ACQ.

Në këtë kuadër, OPERATORI C propozon që të shfuqizohen tërësisht shkronjat a dhe b të pikës 2 të Nenit 19.

- OPERATORI C konsideron se AKEP duhet të miratojë formalisht Specifikimet Teknike për ndërtimin dhe operimin e Bazës Qëndrore të të Dhënave, pasi mungon miratimi formal për Specifikimet Teknike që janë përdorur nga ofruesi i Bazës Qëndrore të të Dhënave (UTI Systems dhe Infosoft).

OPERATORI C konsideron se kjo mangësi formale duhet të korrigohet sikurse edhe dispozita përkatëse në Rregulloren e Portabilitetit që kërkon vetëm publikimin e Specifikimeve Teknike.

OPERATORI C propozon që Neni 19, pika 3 do të ndryshojë si mëposhtë:

“AKEP do të miratojë dhe do të publikojë specifikimet teknike të operimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar dhe të integritit të sistemeve të Operatorëve më këtë Bazë të të Dhenave Referencë të Centralizuar.”

Komenti i AKEP: Operatorët janë dakort me ndryshimin e propozuar. Sugjerime të tjera lidhur me rregulloren nuk janë marrë në konsideratë për këtë fazë të ndryshimeve të propozuara.

AKEP ka propozuar ndryshimin:

9. Tek Shtojca e Rregullores “Kërkesa për bartjen e numrit”, pika 1 e deklaramentit të pajtimitarit të ndryshojë dhe bëhet:

“ 1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës, kam njoftuar ndryshimin e të dhënave të mia të regjistruara tek baza e të dhënave të këtij operatori (nëse ka patur ndryshime të tilla), dhe dëshiroj të anulohet kontratën me operatorin dhënës për këto numra”.

Komentet e operatorëve:

OPERATORI A:

Koment: Pjesa e shtuar e fjalisë prezupozon që pajtimitari ka njoftuar ndryshimin tek baza e të dhënave e operatorit dhënës dhe kjo është situata ideale, e cila nuk përbën pengesë për bashkëpunimin mes operatorit marrës dhe dhënës në hapat e mëtejshëm për të përditësuar/korrigjuar të dhënat e sakta sipas ndryshimeve në nenin 15 dhe 17. Por si do të veprohet në rastet kur pajtimitari nuk ka njoftuar ndryshimin e të dhënave? Kush do konsiderohet përgjegjës për mos realizimin e përditësimit të të dhënave?

OPERATORI C:

OPERATORI C shprehet dakord me ndryshimin e propozuar nga AKEP në pikën 1 të deklaramentit të pajtimitarit.

Nga ana tjetër, OPERATORI C propozon që formulari i Kërkesës për Bartje dhe informacioni i mbledhur nga Pajtimitari në këtë formular të reflektohet dhe në zërat që kërkon ndërfaqja elektronike e Bazës Qëndrore të të Dhënave (CRDB). Cdo informacion i tepërt në ndërfaqen elektronike të CRDB duhet të hiqet dhe kurrësi të mos popullohet me të dhëna kur paraqitet një Kërkesë për Bartje nga Operatori Marrës. Ky ka qënë një problem jo i vogël i hasur në praktikë. Informacioni që Operatori Marrës mbledh me anë të Kërkesës për Bartje të miratuar nga Rregullorja e Portabilitetit është i mjaftueshëm dhe më i pakët sesa informacioni që duhet të

jepet në ndërfaqen elektronike të Bazës Qëndrore të të Dhënave; informacioni i zgjeruar në CRDB është bërë shkak për probleme të panevojshme e të pajiustificuara ligjërisht për bartjen e numrave.

OPERATORI C konsideron se harmonizimin i plotë i informacionit që kërkohet në ndërfaqen elektronike të Bazës Qëndrore të të Dhënave dhe në formularin e Kërkesës për Bartje është i domosdoshëm.

Komenti i AKEP: Operatorët janë dakort me ndryshimin e propozuar. Ndërkohe propozohet që formulari i Kërkesë për Bartje dhe informacioni i mbledhur nga Pajtimtari në këtë formular të reflektohet dhe në zërat që kërkon ndërfaqja elektronike e Bazes Qendrore të të Dhënave (CRDB).

AKEP ka propozuar:

10. Në aktin administrativ vendimmarrës të përcaktohet:

A) Afati i realizimit të përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve nga sipërmarrësit. Ky afat të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.

B) Afati i realizimit të procesit të automatizimit të plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve, nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim. Ky afat të jetë deri në 3(tre) muaj nga data e miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it.

C) Afati i realizimit të ofrimit të shërbimit të portabilitetit të numrit nga të gjithë operatorët që ofrojnë shërbim të telefonisë publike. Ky afat të jetë deri më 30 Qershor 2012.

Komentet e operatoreve:

OPERATORI A:

Koment: Lidhur me përditësimin e të dhënave që propozon AKEP, duhet të sqarohet se çfarë veprimesh nënkupton të ndërmerren nga sipërmarrësit për të realizuar këtë detyrim: Të ndërmarrin fushata sensibilizuese për t'i bërë me dije pajtimtarëve këtë proces? Pavaresisht detyrimit të shprehur të pajtimtarit për të njoftuar ndryshimet e të dhënave, mbetet subjektive bashkëpunimi që do të ofrojnë vetë pajtimtarët në këtë proces përditësimi .

OPERATORI B:

Në lidhje **me piken 10** (mbi afatet e përditësimit të të dhënave të pajtimtarit), në lidhje me pikat e mëposhtme, mendojmë që:

- Për sa i përket pikës A mbi afatin e përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve nga sipërmarrësit (i caktuar deri në 3 muaj nga data e miratimit të aktit nga AKEP), vërehet një paqartësi në përcaktimin e këtij afati nga ana e AKEP.

Lindin pyetjet së cfarë nënkupton AKEP me një përditësim të të dhënave të pajtimtarëve?

Sipas kësaj rregulloreje përditësimi i të dhënave varet nga momenti në të cilin njoftohet nga pajtimtari tek sipërmarrësi me të cilin ka lidhur një kontratë të pajtimit. Kur thuhet që ky afat duhet të jetë deri në 3 muaj nga data e miratimit të aktit nga AKEP, ky formulim është i paqartë për ne dhe për këtë arsye kërkojmë nga AKEP një qartësim për këtë pikë, nëse ky afat duhet të fillojë nga momenti që pajtimtari ka kryer njoftimin e përditësimit të të dhënave tek sipërmarrësi, apo nga momenti i miratimit të aktit nga ana e Këshillit Drejtues të AKEP-it. Gjithsesi afati tre muajor është mjaft i shkurtër dhe i pamundur të realizohet realisht duke marrë parasysh numrin e madh të abonentëve.

- Në lidhje me pikën B, sugjerojmë që afati i realizimit të procesit të automatizimit të plotë të procesit të DBRC-së së centralizuar të bëhet sa me shpejtë të jetë e mundur, në një kohë më të shkurter se afati 3 muajor i propozuar në këtë pikë, për të gjithë problematikën që këta operatorë që nuk e kanë të automatizuar procesin e NP, kanë gjeneruar në marrëdhëniet midis operatorëve, për mbi të gjithë mbi pajtimtarin.
- Pika C mbi afatin e realizimit të shërbimit të portabilitetit të numrit nga të gjithë operatorët përcakton një afat deri në 30 Qershor 2012. Besojmë se AKEP e ka fjalën për NP për telefoninë fikse, sepse për telefoninë mobile ky proces ka një vit që ka mbaruar. AKEP është jashtë cdo afati ligjor për NP në telefoninë fikse. Mendojmë që ky afat të jetë më i afërt se ai i propozuar në këtë pikë, pasi deri më sot nuk kemi pasur një trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët në lidhje me ofrimin e shërbimit të portabilitetit të numrit.

Së fundmi dëshirojmë të propozojmë shtesën në rregullore të një neni në lidhje me anulimin e kërkesës për bartje, kjo pasi ka shumë raste të cilat janë bërë konfliktuale ndërmjet operatorëve dhe nuk gjenin zgjidhje në rregullore. Pra ajo çfarë ne kërkojmë është:

Pajtimtarit duhet ti lindë e drejta e ndërprerjes së procesit të portimit edhe pas kërkesës së aprovuar për portabilitet të numrit. Kjo ndërprerje duhet bërë nga pajtimtari nëpërmjet një formulari të përcaktuar ndërmjet një periudhe të paracaktuar. Duke qënë se mundësia teknike ekziston në të gjithë pjesëmarrësit për plotësimin e kësaj kërkesë duhet vetëm një **Nen** që të bëjë rregullimet ligjore.

Kërkojmë gjithashtu nga ana e AKEP që të organizojë një seance degjimore në lidhje më të gjitha ndryshimet mbi rregulloren e portabilitetit të numrit përpara marrjes së vendimit përfundimtar pasi është shumë e rëndësishme që të diskutohen edhe një herë të gjitha këto çështje për vetë problematikën që ato sjellin.

OPERATORI C:

A- në lidhje me afatin e propozuar nga AKEP për përditësimin e databazës të pajtimtarëve nga Sipërmarrësit brenda 3 muajsh, OPERATORI C shprehet se ky afat është i përzemësueshëm. Databazat përditësohen vetëm kur Pajtimtari ndërvepron me

operatorët dhe paraqet dokumentat formale më të fundit. Pra përditësimi duhet të ndodhë rast pas rasti sa herë që ka kërkesa për bartje dhe jo brenda një afati të shkurtër e të fundëm.

B- OPERATORI C propozon që automatizimi i plotë i procesit nga të gjithë operatorët duhet të implementohet për një periudhë sa më të shkurtër gjithsesi jo më tepër se 2 muaj që nga momenti i miratimit të aktit, pasi diskriminimi që u bëhet operatorëve jo plotësisht të automatizuar vijon tanimë prej me tepër se 2 vitesh (kujtojmë se Rregullorja është miratuar në 7 Prill 2010).

C- OPERATORI C konsideron se duke njoftuar afatin e realizimit të shërbimit të portabilitetit për të gjithë operoret deri në 30 Qershor 2012, AKEP me anë të kësaj dispozite kërkon të ligjerojë standarde të dyfishta rregullatore dhe të vazhdojë të diskriminojë në favor të operatorëve të telefonisë fikse, duke shkelur haptazi parimin e neutralitetit teknologjik. OPERATORI C është e qëndrimit që portabilitetit fiks duhet të hidhet patjetër në treg jo më vonë se 31 Mars 2012, në mënyrë që të shmangen deformime të tjera të konkurrencës në treg.

Komenti i AKEP: Operatorët nuk janë dakort me Afatin prej 3 muajsh të realizimit të përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve nga sipërmarrësit dhe kërkojnë zgjatjen e tij. Gjithashtu kërkojnë shkurtimin e Afatit të propozuar për realizimin e procesit të automatizimit të plotë të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve, nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim. Operatorët nuk janë dakort me afatin e propozuar për realizimin e portabilitetit për të gjithë operatorët deri në 30 Qershor.

Në këto kushte AKEP për shkak të rëndësisë që ka zgjidhja e disa problemeve të lindura deri tani në zbatimin e portabilitetit dhe krijimin e lehtësirave për përdoruesit në realizimin e procesit të bartjes nuk ndryshon propozimin e tij për Afatin prej 3 muajsh të realizimit të përditësimit të të dhënave të pajtimtarëve ne bazat e të dhënave nga sipërmarrësit. AKEP, nuk do të shkurtojë afatin e propozuar për realizimin e procesit të automatizimit të plotë të procesit të përditësimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar pasqyrë për rrugëzimin e thirrjeve, nga të gjithë sipërmarrësit pa përjashtim me qellim që tju krijohet hapësira e nevojshme të gjithë operatorëve që veprojnë në treg për të mundësuar implementimin e këtij ndryshimi në sistemet e tyre.

Operatorët sugjerojnë edhe një korrektim në Nenin 15 të rregullores. Ndryshon numri në renditjen e paragrafëve, sepse kalon nga numri 3 në numrin 5.